

VENDIM
Nr. 1028, datë 27.11.2013

**PËR PJESËMARRJEN NË STËRVITJEN SHUMËKOMBËSHE TË NJË KOMPANIE
KËMBËSORIE TË KOMANDËS SË FORCËS TOKËSORE DHE TË NJË TOGE TË POLICISË
USHTARAKE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
QENDRËN E BASHKUAR NDËRKOMBËTARE TË GATISHMËRISË (JMRC) NË
HOHENFELS, GJERMANI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të pikës 2 të nenit 8 të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pjesëmarrjen në stërvitjen shumëkombëshe të një kompanie këmbësorie të Komandës së Forcës Tokësore dhe të një toge të Policisë Ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, me personel 150 ushtarakë, në Qendrën e Bashkuar Ndërkombëtare të Gatishmërisë (JMRC) në Hohenfels, Gjermani.

2. Qëllimi i kësaj stërvitjeje është trajnimi i trupave dhe rritja e kapaciteteve operacionale dhe e ndërveprueshmërisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

3. Kohëzgjatja e stërvitjes është nga data 14.1.2014 deri në datën 4.2.2014.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të mbulohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

5. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama